



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.07.2024

Nr: 112

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË DEMOKRATIKE PËR REGJISTRIMIN SI  
SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË  
HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024**

Sot më datë 23.07.2024, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 2089 Prot., datë 22.07.2024, me:

**Kërkues:** “Partia Demokratike”, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Demokratike” (PD), si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**VËREJ:**

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 244, datë 5.7.2024, ka caktuar datën 4 Gusht 2024, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë.

Data: 23.07.2024 Nr: 112  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

“Partia Demokratike”, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 Gusht 2024.

Nga “Partia Demokratike” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 22.07.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Demokratike” me shkronja nistore, PD ose PDSH, përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemlimit rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Demokratike” me shkronja nistore “PD”, me adresë Bulevardi Zhan D’ark, nr. 11, Tiranë;
- b) Financieri i partisë është z. Arben Ibroja, me adresë Bulevardi Zhan D’ark, nr. 11, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Ivi Kaso dhe z. Franci Nuri, me adresë Bulevardi Zhan D’Ark, nr. 11, Tiranë;
- c) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Demokratike”, respekton afatin kohor të parashikuar në vendimin nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”. Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Demokratike”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 3 datë 17.07.2024, të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Himarë, që do të zhvillohen më datë 4 gusht 2024”.

Data: 23.07.2024 Nr:112  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024”.

## VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me shkronjat nistore “PD”, drejtuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, i përfaqësuar nga z. Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 Gusht 2024.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orë nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje 3

Afati i ruajtjes 5 vjet

Konceptoi: J.Dedaj \_\_\_\_\_

Miratoi: P.Doçaj \_\_\_\_\_

Aprovoi: J. Josifi \_\_\_\_\_

M.Çelmeta \_\_\_\_\_